

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - SHKURT 2025

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	02.02.2025	Informacion	03.02.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj për informacion të dërguar në adresën elektronike të AZHT, referojuni bazës ligjore bashkëlidhur për informacionin rreth Lejes së Ndërtimit dhe Lejes së Zhvillimit, për të cilat ju interesoheni.	E plotë	Nuk ka
2	04.02.2025	Kërkesë për informacion	04.02.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion të dërguar në adresën elektronike të AZHT...,ju bëjmë me dije se mandati i pagesës së gjobës shkarkohet nga portali e-albania, të cilin mund ta gjeni në kategorinë "Mesazhet e mia" ose "Dokumentat e mia", ku si fillim duhet të logoheni me të dhënat e personit i cili ka realizuar aplikim për lejen në fjalë.	E plotë	Nuk ka
3	10.02.2025	Kërkesë/ Ankesë	03.03.2025	Në përgjigje të akësës suaj..Ju bëjmë me dije,si më poshtë vijon: Pranë AZHT,si Sekretariat Teknik i KKT,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikimi.... Në vijim, në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij..... Në vijim pranë AZHT,si Sekretariat Teknik i KKT,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikimi.... Sqarojmë se,referuar Ligjit Nr.107/2014 Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar,në Nenin nr.7,"Përgjegjësitë e KKTU",gërma ç),përcaktohet se:"<u>KKT-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet kompetencë e saj</u>".Në përputhje me këtë dispozitë, Ju bëjmë me dije.... Nga verifikimi i kryer ...pranë AZHT-së,konstatohet se pasuria në zhvillim....AZHT, ka kryer procedurat e nevojshme për respektimin e distancave,sipas legjislacionit në fuqi për pronën tuaj në projekt-propozimin e depozituar. Gjithashtu ju informojmë se vendimet i gjeni të publikuara në faqen web të AZHT: https://azht.gov.al.	E plotë	Nuk ka

4	10.02.2025	Kërkesë	17.02.2025	Në përgjigje të kërkesave Tuaja...,Ju bëjmë me dije,si më poshtë vijon: AZHT e cila aktualisht funksionin si Sekretariat Teknik të KKTU-së, në mbështetje të VKM Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, ka kompetencë pranimin, <i>përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKT-së</i>. Pranë AZHT,është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik e-Leje,aplikimi.... Në vijim,në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,KKT në mbledhjen... Përfitojmë nga rasti t'ju sqarojmë se,dokumentacioni i pronësisë që administrohet nga AZHT,gjatë aplikimeve për leje zhvillimi,referuar Nenit 10 "Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi",të VKM-së Nr.4085,datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",i ndryshuar,ku parashikohet në mënyrë të detajuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor që duhet të paraqesin aplikuesit për miratimin e lejeve të zhvillimit,ndër të tjera,si një nga dokumentet themelore përmendet "...dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim..."(pika 1,shkronja "c"). Të gjitha dokumentet e origjinës së pronës ,shqyrtohen/verifikohen në momentin e regjistrimit pranë ASHK-së,apo Drejtorive rajonale të saj,të cilat administrojnë të gjitha aktet/dokumentet mbi bazën e të cilit kryhet regjistrimi dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi bazën e parimit të ligjshmërisë. Bashkëlidhur gjeni të evidentuar gjurmën.... Duke Ju falenderua për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
5	12.02.2025	Ankim	27.02.2025	 Në përgjigje të kërkesës Suaj,bashkëlidhur gjeni shkresën....të Agjencisë së Zhvillimi të Territorit drejtuar shoqërisë..... Duke Ju faqlenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

6	14.02.2025	Kërkojmë një kopje të lejes së zhvillimit/ndërtimit të.....	19.03.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...ju bëjmë me dije: AZHT e cila aktualisht kryen funksionet e Sekretariat Teknik të KKTU-së, është krijuar me VKM Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.Në mbështetje të VKM-së sipërcituar,kjo Agjenci ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Për sa më sipër,në përfundim të procesit të zbardhjes, Vendimin...,mund ta gjeni të publikuar së bashku me dokumentacionin që e shoqëron,në faqen zyrtare web të AZHT:https://azht.gov.al,në rubrikën "Vendimi KKT".	E plotë	Nuk ka
7	17.02.2025	Kërkesë	20.02.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj, ju informojmë se:AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariati Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit është krijuar me VKM-në Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, dhe në përputhje me Kreun III "Përgjegjësitë dhe detyrat e agjencisë",pika 1,të këtij vendimi,ka kompetencë pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKT-së, me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit dhe/apo ndërtimit,për të gjitha tipologjitë e zhvillimeve,shqyrtimi dhe vendimmarrja për të cilat, është kompetencë e KKTU-së. Për sa më lart,referuar kërkesës Suaj,pas verifikimeve përkatëse në databazë,në pasuritë e paliajtshme të listuara nga ana juaj,nuk evidentoi asnjë vendimarrje për Leje Zhvillimi/Ndërtimi të KKTU.	E plotë	Nuk ka
8	18.02.2025	Kërkesë ankimore (për informacion dhe lëshimin e kopjeve të akteve zyrtare)	17.03.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj..Ju sqarojmë si më poshtë vijon: Bazuar në vendimin.... Për sa më sipër, ju informojmë se sapo të përfundojë procesi i konfirmimit të Vendimit të KKT....,do e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të AZHT: www.azht.gov.al,në rubrikën "Vendime KKT". Duke Ju falenderuar,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

9	18.02.2025	Kërkesë	20.02.2025	 Pas shqyrtimit të kërkesës Tuaj, gjeoreferimit dhe evidentimit të vendodhjes të pasurisë, si dhe referuar përcaktimeve të bëra në shkresë mbi ndërtimin e rrethimit të pronës ju infomojmë se: Ngritja e murit rrethues dhe rrethimi i pronës sipas VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar, parashikohet në: -Nenin 7 "<i>Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh</i>" -Neni 6/1 "<i>Ndërhyrje me njoftim/punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi në zonat rurale</i>" Ndërkohë pasuria në të cilën kërkoni të kryeni zhvillimin shtrihet në.....sipas VKM-së Nr.784 datë 18.12.2024 "Për përcaktimin e rregullave për zhvillimin e zonave aeroportuale" i ndryshuar ku citohet se: -për kërkesat për leje me jo më shumë se 15metra lartësi nga toka janë kompetencë shqyrtimi nga autoritetet vendore Për sa më sipër dhe referuar tipologjisë së zhvillimit Ju citojmë se autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës Tuaj dhe miratimin e saj është njësia e vetëqeverisjes vendore përkatësisht....	E plotë	Nuk ka
---	------------	---------	------------	--	---------	--------

10	20.02.2025	Info për ndërtimin e shtëpive prej druri	20.02.2025	Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion të dërguar në adresën elektronike të AZHT, bazuar në VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar (këtu bashkëlidhur), përkatësisht Neni 7 - 'Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh', në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit "e-leje" për pajisje me leje ndërtimi, pika 3 ku citohet sa më poshtë ; <i>i. struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe/ose të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura beton-armeje, blloqe betoni, muratura e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 12-mujor nga momenti i lëshimit ;</i> lutemi referojuni bazës ligjore bashkëlidhur ku gjendet informacioni i plotë dhe i saktë ligjor për aplikim për leje zhvillimi dhe ndërtimi, etj.. Në këtë dokument mund të informoheni mbi dokumentat e nevojshëm për aplikim, afatet e procesit nga momenti i aplikimit deri në finalizimin e tij, palët e përfshira në proces (zhvilluesi,projektuesë të licencuar dhe autoritetet vendimmarrëse) si dhe procesin e hartimit të dokumentacionit të kërkuar për aplikim në portalin elektronik të vetëm qeveritar "e-albania", në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit "E-Leje". Gjithashtu, ju informojmë se për informacion dhe sqarim më të saktë, bashkë me dokumentat që zotëroni, mund të paraqiteni pranë sporteleve të informacionit të bashkisë përkatëse.	E plotë	Nuk ka
11	20.02.2025	Informacion	21.02.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj për informacion të dërguar në adresën elektronike të AZHT, ju bëjmë me dije se informacionin për mbledhjet KKT e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të web të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit: www.azht.gov.al, në rubrikën "Njoftimet e fundit".	E plotë	Nuk ka

12	20.02.2025	Pezullimin e zbatimit të Lejes së Ndërtimit për.....	03.03.2025	Në përgjigje të aknesës Suaj...Ju bëjmë me dije,si më poshtë vijon; AZHT e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit në mbështetje të Vendimit Nr. 725, datë 02.09.2015 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, ka kompetencë <i>pranimin, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së.</i> Pranë AZHT, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikimi.... Në vijim, në përputhje me Ligjin Nr107/2014"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij,KKTU, në mbledhjen..... Sqarojmë se, referuar Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar, në Nenin 7, "Përgjegjësitë e KKTU",gërma ç),përcaktohet se:" <i>KKTU-ja vendos miratimin e rregulloreve të veçanta për kushtet e zhvillimit për rastet në kompetencë të saj.</i>". Në përputhje me këtë dispozitë, Ju bëjmë me dije se në pikën nr.2 të.....të sipërcituar.përcaktohet se Gjithashtu,ju informojmë se vendimet i gjeni të publikuara në faqen web të AZHT:https://azht.gov.al	E plotë	Nuk ka
13	26.02.2025	Kërkesë			Në proces	Nuk ka
14	27.02.2025	Kërkesë			Në proces	Nuk ka
15	28.02.2025	Kërkesë			Në proces	Nuk ka